



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Prishtinë, 12 shkurt 2020
Kodi i ZRRE-së: V_1226_2020

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, nenin 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.15, nenin 25, neni 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.05/L-084),
- Nenin 16 të Rregullës për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Kapaciteteve të reja,
- Vendimi për Lëshimin e Autorizimit Final V_760_2016 të datës 28 janar 2016 për shoqërinë "Matkos Group" SH.P.K., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga uji, HC "Shtërpce" me kapacitet të instaluar prej 5.031 MW, ZK Shtërpce, komuna e Shtërpçës,
- Vendimin V_934_2018 të datës 29 mars 2018 dhe Vendimin V_1112_2019 të datës 28 shkurt 2019 për shtyrje të afatit të vlefshmërisë të Vendimit për Autorizimin Final V_760_2016 të datës 28 janar 2016, lëshuar shoqërisë "Matkos Group" SH.P.K., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga uji, HC "Shtërpce" me kapacitet të instaluar prej 5.031 MW, ZK Shtërpce, komuna e Shtërpçës, dhe
- Kërkesën për shtyrjen e afatit të vlefshmërisë së Vendimit për Autorizim Final V_760_2016 i datës 28 janar 2016 edhe për dymbëdhjetë (12) muaj, për ndërtimin e kapacitetit të ri gjenerues për prodhim të energjisë elektrike nga Uji, HC "Shtërpce" me kapacitet të instaluar prej 5.031 MW, ZK Shtërpce, komuna e Shtërpçës, të datë 17.01.2019 nr. prot. 034/20 të shoqërisë "Matkos Group" SH.P.K., me adresë rruga "Veternik" 10000, Prishtinë, Republika e Kosovës,

në seancën e mbajtur me datë 12 shkurt 2020 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **APROVOHET** kërkesa e shoqërisë "Matkos Group" SH.P.K. dhe **SHTYHET** afati i vlefshmërisë së Autorizimin Final V_760_2016 i datës 28 janar 2016, për ndërtimin e Hidrocentralit HC "Shtërpce" me kapacitet të instaluar prej 5.031 MW, ZK Shtërpce, Komuna e Shtërpçës, edhe për dymbëdhjetë (12) muaj.

A r s y e t i m

- o ZRRE me datë 29.03.2013 nga shoqëria "Matkos Group" SH.P.K., ka pranuar aplikacionin për marrjen e autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë



elektrike nga Uji, në Lumin Lepenc, për HC "Shtërpce" me kapacitet të instaluar prej 5.031, në Komunën e Shtërpcës

- Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, pas analizimit të dëshmive të prezantuara nga shoqëria "Matkos Group" SH.P.K., ka vendosur se aplikuesi ka dëshmuar përshtatshmërinë për zhvillimin e projektit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga Uji, dhe ka lëshuar Vendimin mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V_541_2013 me datë 28 qershor 2013. Vendim mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar, nuk ka nënkuptuar edhe lëshimin e Autorizimit, përderisa nuk plotësohen kërkesat e përcaktuara me Rregullën e Procedurës së autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja.
- ZRRE me datë 24.06.2015 nga shoqëria "Matkos Group" SH.P.K., ka pranuar kërkesën për vazhdimin e afatit të vlefshmërisë së Vendimit V_541_2013 të datës 28 qershor 2013 mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar për HC Shtërpce, Komuna e Shtërpcës, për kompletimin e aplikacionit për marrjen e Autorizimit Final.
- Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, pas analizimit dhe vlerësimit të kërkesës dhe dëshmive relevante të prezantuara nga shoqëria "Matkos Group" SH.P.K., me datë 16.07.2015 ka vendosur me Vendimin V_744_2015 për shtyrjen e afatit të vlefshmërisë së Vendimit V_541_2013 të datës 28 qershor 2013, edhe për 6 (gjashtë) muaj, gjegjësisht deri me 28 dhjetor 2015, në mënyrë që brenda kësaj periudhe të kompletohet aplikacioni sipas legjislacionit në fuqi.
- ZRRE me datë 12.11.2015 nga shoqëria "Matkos Group" SH.P.K., ka pranuar kërkesën për shndërrimin e Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga Uji në Autorizim Final për HC "Shtërpce" me kapacitet të instaluar prej 5.031 MW, në Lumin Lepenc lokacionin ZK Shtërpce, Komuna e Shtërpcës, duke i bashkangjitur dëshmitë e lëshuara nga autoritetet relevante për përmbushjen e të gjitha kërkesave mjedisore, të drejtën mbi shfrytëzimin e tokës, të drejtat mbi shfrytëzimin e ujit, Lejen Ndërtimore dhe kërkesat e tjera ligjore që lidhen me natyrën e projektit sipas legjislacionit në fuqi.
- Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, me datë 28.01.2016 ka vendosur që shoqërisë "Matkos Group" SH.P.K., ti lëshohet Autorizimi Final V_760_2016 për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese, për prodhimin e energjisë elektrike nga Uji, për HC "Shtërpce" me kapacitet të instaluar prej 5.031 MW, njësia gjeneruese që do të vendoset në lokacionin ZK Shtërpce, Komuna e Shtërpcës.
- ZRRE me datë 11.01.2018 nga shoqëria "Matkos Group" SH.P.K., ka pranuar kërkesën për vazhdimin e afatit të vlefshmërisë të Vendimit për Autorizimin Final V_760_2016 të datës 28 janar 2016, për HC Shtërpce me kapacitet të instaluar prej 5.031 MW, për përfundimin e ndërtimit edhe për një (1) vit, gjegjësisht deri me 28 janar 2019.
- Bordi i ZRRE-së, në mbledhjen e mbajtur me datë 29 mars 2018, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të kërkesës dhe dëshmive relevante, ka aprovuar kërkesën e shoqërisë "Matkos Group" SH.P.K., dhe me vendimin V_934_2018 ka vendosur që ti lejohet shtyrja e afatit të vlefshmërisë të vendimit për autorizimin Final V_760_2016 të datës 28 janar 2016 edhe për një (1) vit, gjegjësisht deri me 28 janar 2019, në pajtim me dispozitat ligjore të Rregullës për procedurën e Autorizimit.



- ZRRE me datë 18.01.2019 nga shoqëria “Matkos Group” SH.P.K., ka pranuar kërkesën për vazhdimin e afatit të vlefshmërisë të Vendimit për Autorizimin Final V_760_2016 të datës 28 janar 2016, i vazhduar me vendimin V_934_2018 të datës 29 mars 2018 për HC Shtërpce me kapacitet të instaluar prej 5.031 MW, për përfundimin e ndërtimit edhe për një (1) vit, gjegjësisht deri me 28 janar 2020.
- Bordi i ZRRE-së, në mbledhjen e mbajtur me datë 28 shkurt 2019, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të kërkesës dhe dëshmive relevante, ka aprovuar kërkesën e shoqërisë “Matkos Group” SH.P.K., dhe me vendimin V_1112_2019 ka vendosur që ti lejohet shtyrja e afatit të vlefshmërisë të vendimit për autorizimin Final V_760_2016 të datës 28 janar 2016 edhe për një (1) vit, gjegjësisht deri me 28 janar 2020, në pajtim me dispozitat ligjore të Rregullës për procedurën e autorizimit.
- ZRRE me datë 17.01.2020 nga shoqëria “Matkos Group” SH.P.K., ka pranuar kërkesën për vazhdimin e afatit të vlefshmërisë të Vendimit për Autorizimin Final V_760_2016 të datës 28 janar 2016, i vazhduar me vendimin V_934_2018 të datës 29 mars 2018 dhe Vendimin V_1112_2019 të datës 27 shkurt 2019 për HC Shtërpce me kapacitet të instaluar prej 5.031 MW, për përfundimin e ndërtimit edhe për dymbëdhjetë (12) muaj.
- Shoqëria “Matkos Group” SH.P.K., në kërkesën e saj ka sqaruar se: *arsyeja pse janë detyruar të parashtrorjnë kërkesë për shtyje shtesë të afatit, janë për shkak të pengesave të cilat janë shfaqur jashtë kontrollit të kompanisë që kanë shtyrë përfundimin e këtij hidrocentrali, problemeve të vazhdueshme që janë hasur nga disa banor lokal të asaj zone, dhe si vonesa janë shkaktuar edhe nga organet e Komunës së Shtërpçës të cilat kanë rezultuar deri te mos përfundimi i punëve ndërtimore ashtu siç është paraparë.*
- Shoqëria “Matkos Group” SH.P.K., ka sqaruar se *projekti HC Shtërpce është finalizuar pothuajse në tërësi, pas shumë vështirësive dhe pengesave të vazhdueshme në terren, janë përfunduar objektet e hidrocentralit janë duke u planifikuar të vendosen turbinat s’bashku me makinerit përcjellëse, është përfunduar vepra e marrjes dhe tubacioni në përfundim e sipër dhe të gjitha punimet janë duke u kryer sipas projekti dhe posa të vendosen edhe gjeneratorët do të janë të gatshëm që të fillojnë fazën testuese duke përdorur ujin sipas pëlqimit të kushteve ujore të lëshura nga MMPH.*
- Shoqëria “Matkos Group” SH.P.K., me datë me datë 28 qershor 2018 përmes emailit zyrtar iu është drejtuar Komunës së Shtërpçës, në lidhje me njoftimin e dërguar me datë 18 shtator 2017, lidhur me punët që ishin duke u realizuar në ndërtimin e Hidrocentralit HC Shtërpce në pajtim me lejet përkatëse dhe legjislacionin në fuqi, duke i konfirmuar edhe nga Ministria e ambientit se punimet ishin duke u realizuar në pajtim me Pëlqimin Ujor dhe Lejen ndërtimore. Përmes këtij emaili është njoftuar Drejtori i Departamentit të Urbanizimit, se do të vazhdojmë me punimet e mbetura nga data 2 korrik 2018.
- Nga përgjigja me shkrim e pranuar me datë 29.06.2018, janë informuar se Kuvendi Komunal i Komunës së Shtërpçës me datë 29.05.2018 ka marr vendim për pezullimin e të gjitha llojeve të ndërtimit duke përfshirë edhe ato të karakterit të përkohshëm në qendrën e skijimit në Brezovicë, deri në gjetjen e ndonjë partneri strategjik për zhvillimin e kësaj qendre.



- Jemi informuar gjithashtu që është përgjegjësi e ekzekutivit të zbatojë këtë vendim dhe unë ju kërkoj që të zbatoni këtë vendim dhe të mos filloni ndonjë punë në territorin e qendrës së skive deri në njoftimin e mëtejshëm me kërcënimin se “Nëse nuk jeni në pajtim me këtë vendim, komuna e Shtërpcës do të veprojë në përputhje me vendimin e mësipërm dhe do të marrë masat e duhura”, duke mos dhënë asnjë arsytim ligjor se i njëjti Departament, Shoqërisë “Matkos Group” SH.P.K., i ka lëshuar lejet ndërtimore për ndërtimin e Hidrocentraleve HC Brezovica i realizuar dhe në prodhim komercial për prodhimin e energjisë elektrike nga BRE, Hidrocentralin HC Vica në realizim e sipër, HC Shtërpca në proces të ndërtimit dhe HC Sharri i cili është në ndërtim sipas lejes përkatëse ndërtimore, por i njëjti sipas këtij vendimi është i pezulluar përkohësisht.
- Shoqëria “Matkos Group” SH.P.K., duke parë se Komuna e Shtërpcës ka nxjerr një vendim të kundërligjshëm në dëm të investimeve, ka shfrytëzuar të drejtën e saj dhe ka parashtruar kërkesë në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal (MALP) dhe Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë, për shqyrtim të ligjshmërisë së Vendimit për ndalimin e të gjitha ndërtimeve duke përfshirë edhe ato të karakterit të përkohshëm nr. 01-020/18-6982/18 të datës 31.05.2018. të kuvendit komunal të Shtërpcës.
- Ministria e Administrimit dhe Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të kërkesës nr. 020-647/4, për shqyrtimin e ligjshmërisë së Vendimit Nr. 01-020-08-6982/18 të datës 29.05.2018 për ndalimin e të gjitha ndërtimeve duke përfshirë edhe ato të karakterit të përkohshëm në qendër të skijimit në Brezovicë deri në gjetjen e ndonjë partneri strategjik për zhvillimin e kësaj qendre, i cili është miratuar nga Kuvendi Komunal i Shtërpcës, me datë 14.09.2018 ka dhënë përgjigjen me shkrim nr. 020-647/4 me të cilën ka theksuar që: MALP, në përputhje me mandatin ligjor të përcaktuar me Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale dhe Rregulloren Nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive Shtojca XII, duke u bazuar në Raportin e monitorimit të mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal të Komunës së Shtërpcës ka konstatuar se Vendimi Nr. 01-020-08-6982/18 të datës 29.05.2018 Kuvendit Komunal të Komunës, me shpresën përcjellëse iu është dërguar Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) për vlerësimin e ligjshmërisë.
- Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) me datë 17.07.2018 pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, ka vlerësuar se akti i komunës është i kundërligjshëm me dispozitat e legjislacionit në fuqi. Mos pajtueshmëria e aktit të komunës i parashtruar për shqyrtim të ligjshmërisë ka të bëjë me atë që: “Vendimi i Kuvendit Komunal i Komunës së Shtërpcës Nr. 01-020-08-6982/18 për ndalimin e të gjitha ndërtimeve duke përfshirë edhe ato të karakterit të përkohshëm në qendër të skijimit në Brezovicë deri në gjetjen e ndonjë partneri strategjik për zhvillimin e kësaj qendre, është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi neni 77,78 dhe 80 të Ligjit për Mbrojtje të Natyrës Nr. 03/L-233, Planit Hapësinor të Parkut Kombëtar Sharri dhe Planit Menaxhues të Parkut Kombëtar Sharri, i cili administrohet nga Drejtoria për Administrimin e Parkut Kombëtar Sharri/Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës – MMPH.
- Gjithashtu ka sqaruar se Qendra e Skijimit në Brezovicë, është brenda Parkut Kombëtar Sharri në zonën e tretë mbrojtëse, e cila zonë bie në kompetencë të Institucioneve Qendrore gjegjësisht Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, dhe MMPH i ka propozuar MALP-it që të kërkojë nga Kuvendi i Komunës/Kryetari i Komunës së Shtërpcës që të ndërmerr veprime konkrete që aktin e komunës ta harmonizojë me dispozitat ligjore në fuqi, brenda 30 ditësh nga data e pranimit të kërkesës për rishqyrtim të aktit.



- Poashtu në shkresën e datës 16.08.2018 Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në përgjigjen me shkrim ka sqaruar se në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/2016 për shqyrtimin administrativ të akteve komunale, dhe në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për fushat dhe përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka shqyrtuar kërkesën për vlerësimin obligativ të ligjshmërisë së vendimit të Kuvendit Komunal i Komunës së Shtërpcës Nr. 01-020-08-6982/18 dhe ka konstatuar se akti komunal është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.
- Shoqëria "Matkos Group" SH.P.K., pas pranimit të përgjigjes me shkrim nga MALP dhe Ministria e Ambientit, ju ka drejtuar Komunës së Shtërpcës, ku e ka njoftuar për vazhdimin e punimeve në realizimin e projektit HC Shtërpce sipas dinamikës së punimeve të planifikuara për realizimin e tyre edhe përkundër vështirësive të mëdha.
- Mirëpo pas konfirmimit nga komuna e Shtërpcës se mund të vazhdohet me punime në hapjen e veprës së marrjes, trasesë së tubacionit dhe të hidrocentralit, pengesat janë paraqitur nga komuniteti i asaj zone, ku kanë dal dhe kanë pengua në kryerjen e punëve, të cilat pas konsultimit me Kryetarin e komunës së Shtërpcës, me datë 31 dhjetor 2018, është mbajtur takimi me përfaqësuesit e komunitetit, përfaqësuesit e Ministrisë së Ambientit dhe të Policisë së Kosovës, është arritur pajtimi që të lejohet realizimi i këtij projekti. Këto vështirësi, të shkaktuara nga komuna e Shtërpcës, na kanë përcjelluar edhe tek realizimi i HC Brezovica dhe HC Vica për të cilën edhe ju kemi njoftuar, po ashtu e njëjta situatë ka qenë edhe te projekti i HC Sharri, edhe pse ne jemi pajisur me tërë dokumentacionin e nevojshëm nga komuna e Shtërpcës dhe institucionet tjera.
- Poashtu gjatë vitit 2019 që nga pranvera kur janë krijuar kushtet për vazhdimin e punimeve, kanë vazhduar me realizimin e këtij projekti, por në vazhdimësi kanë hasur në pengesa nga banorët lokal, edhe pse gjatë gjithë kohë janë njoftuar se janë duke punuar në harmoni me të gjitha kërkesat ligjore të institucioneve të Kosovës, dhe në asnjë rast nuk do të pengohen pronat private e as lumi nuk do të zvogëlohet, pasi që janë të obliguar pas finalizimit të veprimeve sipas lejes ujore dhe duhet të respektohet edhe minimumi biologjik sipas udhëzimit të Ministrisë.
- Shoqëria "Matkos Group" SH.P.K., ka sqaruar se edhe pse kanë pritur se do të sqarohen paqartësitë nga ana e komunës së Shtërpcës disa banor prapë kanë paraqitur probleme dhe në disa raste edhe janë dëmtuar pajisjet teknike, me të vetmin qëllim që të mos të punohet në atë pjesë, edhe pse vepra e marrjes dhe godina e hidrocentralit janë kryer dhe nuk ka pasur pengesa.
- Duke parë, se nuk ka mundësi të punohet në maj të vitit 2019 kanë parashtruar kërkesë pranë Policisë së Kosovës në Ferizaj, ku kanë kërkuar asistencën e tyre, për vazhdimin e punimeve dhe ruajtjen e punëtorëve gjatë kryerjes së punimeve. Policia e Kosovës në vazhdimësi i ka përcjell punimet vetëm gjatë ditëve të punës, ndërsa gjatë vikendeve janë detyruar ti ndalojnë.
- Poashtu theksohet se punimet në vazhdimësi janë përcjellur në teren nga Inspektorati i Ministrisë së ambientit, punimet janë monitoruar kohët e fundit në vazhdimësi nga policia e Kosovës, komuna ka monitoruar punimet a janë duke u kryer sipas lejes ndërtimore.



- Shoqëria “Matkos Group” SH.P.K., në kërkesën e saj ka sqaruar se pas kërkesës me shkrim drejtuar Komunës së Shtërpcës nr. 02-150/02-7873/19, kanë pranuar përgjigje me shkrim me datë 09 korrik 2019 ku është konfirmuar se, në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, si dhe dëshmitë e ofruara është konfirmuar se mund të vazhdohet realizimi i ndërtimit të HC Sharri dhe HC Shtërpce dhe HC Vica në Komunën e Shtërpcës duke i respektuar të gjitha lejet, pëlqimet dhe dokumentet e lëshuara nga organet kompetente gjatë realizimit të punimeve konform legjislacionit në fuqi.
 - Shoqëria “Matkos Group” SH.P.K., thekson se edhe përkundër që kanë qenë të pajisur me pëlqim elektroenergetik për tu kyçur në nënstacionin e Shtërpcës, nga an e KEDS kanë pasur vonesa në vazhdimësi për të cilat keni qenë të informuar, ku pas diskutimeve me përfaqësuesit e KEDS më në fund me datë 17.01.2020 nr. 245 kanë pranuar Pëlqimin Elektroenergetik (vazhduar), dhe tashmë edhe mund të bëhen porositi për pajisjet energjetike sipas këtij pëlqimi.
 - Arsyeja, pse kanë kërkuar që të shtyhet afati i vlefshmërisë së autorizimit final për projektin HC Shtërpca është se edhe përkundër angazhimeve tona në përfundimin e realizimit të këtij projekti me interes, ky projekt nuk arriti të përfundohet brenda kësaj kohe, për shkak të problemeve të vazhdueshme të shkaktuara nga Komuna e Shtërpcës dhe komuniteti i asaj zone të cilat i kemi cekur më lartë. Marr parasysh faktin dhe natyrën komplekse të projekteve në fushën e Hidrocentraleve, dhe pengesave të vazhdueshme, këto kanë qenë bazë e vonesave për përfundimin e projektit në fjalë, brenda afatit të parë të caktuar nga ZRRE dhe me mirësi kërkojnë nga Bordi i ZRRE që të na mundësoj shtyrjen e vendimit mbi autorizimin edhe për dymbëdhjetë (12) muaj sipas dispozitave ligjore të rregullës së autorizimit.
 - Andaj, bazuar në ato që u cekën më lartë, kërkojnë nga Bordi i ZRRE-së, që mbështetur në dispozitat e nenit 16 të Rregullës së Autorizimit, t’iu mundësohet shtyrja e afatit të vlefshmërisë së Autorizimit Final V_760_2016 edhe për dymbëdhjetë (12) muaj deri me 28 janar 2021, pasi që pengesat për mos realizimin e këtij Hidrocentrali HC Shtërpca me kapacitet të instaluar prej 5.031 MW, ZK Shtërpca, komuna e Shtërpcës brenda këtyre afateve, kanë qenë jashtë kontrollit të kompanisë Matkos Group SH.P.K., pasi që edhe me planin dinamik fillestar nuk kanë mundur të zbatohen, për arsytet dhe dëshmitë e paraqitura më lartë, poashtu duke parë se janë realizuar më shumë se 80% të punimeve në terren, shpresojnë se edhe zgjatja e afatit prej 12 muajsh do të ishte e mjaftueshme për finalizimin e këtij projekti.
 - Bordi i ZRRE-së, pas analizimit të kërkesës së shoqërisë “Matkos Group” SH.P.K., dhe dëshmimeve të bashkangjitura për shtyrje të afatit të vlefshmërisë të Autorizimit Final, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga uji, në Lumin Lepenc HC Shtërpce me kapacitet të instaluar prej 5.031 MW, në Komunën e Shtërpcës, ka vlerësuar ato, ka konsideruar se për shkak pengesave të paraqitura jashtë kontrollit të investitorit dhe të kompleksitetit të ndërtimit të Hidrocentraleve, ku janë prezantuar fakte se brenda kësaj periudhe do të finalizohet projekti dhe duke u mbështetur në shkresat e lëndës, ka vendosur që të lejohet shtyrja e afatit të vlefshmërisë së Autorizimit Final V_760_2016 i datës 28 janar 2016, edhe për një afat shtesë prej dymbëdhjetë (12) muaj, duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi.
- II. Vendimi për Lëshimin e Autorizimit Final V_760_2016 i datës 28 janar 2016, do të vlen deri me datë **28 janar 2021**, sipas dispozitivin nën pikën I., të këtij vendimi, dhe në rast se nuk arrin të përfundojë ndërtimin e stabilimenteve të reja gjeneruese nga Uji, apo nuk vepron në pajtim me legjislacionin në fuqi, vendimi do të shfuqizohet.



III. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i Rregullatorit:


Arsim Janova, U.D. kryesues


Besim Sejfiqaj, anëtar


Selman Hoti, anëtar


Izet Bushati, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Palës,
- Komunës së Shtërpcës,
- Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH-së, dhe
- Arkivit të ZRRE-së